



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Muhamet Mucici BI” të datës 27.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Muhamet Mucici BI” të datës 27.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Muhamet Mucici BI” (tutje “parashtruesi”) me datë 27.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov” me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

"Ky arsyetimi nga AK – zyrtari i prokurimit, deshmon shume qarte dhe bindes se nuk eshte vleresuar dhe me qellim jemi eliminuar, per faktin se teksti tregon ku thote po citojm: "nuk keni oferte te papergjegjshem per arsye se GOE-ik me oferten e tij nuk ka dorezuar sipas kerkese se DT-se dhe njoftimit per kontrate:" qe i bie se teksti "nuk keni oferte te papergjegjshme" d.m.th. edhe ata e din se vertet kemi ofert te pergjegjshem, po ashtu nuk jemi grupi i OE po jemi vetem nje OE etj..... Po ashtu, nese e marrim per baze edhe Letren standarde te sqarimit te tenderit te dates 14.05.2025 te cilen e kemi pranuar nga AK, permes platformes elektronike, qe kerkon sqariime pikerisht per staf dhe "Automikeser per prodhim te betonit" si dhe pergjigjien tonet e dates: 16.05.2025 ku kemi sqaruar ne menyre te DETAJUAR sa i perket AUTOMIKSERIT per prodhimin e mikeserit, duke ofruar te gjitha deshmit me dokumente dhe regjistrim valid dhe sqarimi ne teresi per kete paisje qe dot e thote se jane ne pajtim te plote me dosjen e tednerit dhe njoftimin per kontratë – duke plotesuar ne teresi kriteret e perzgjedhjes dhe kriterin kryeros te dhenies se kontrates- çmimi me i ulët i pergjegjsehm.

Ky fakte dhe argumente deshmon dhe argumenton se ne kemi plotesuar ne teresi kete kerkes te DT dhe NJK, duke dorezuar te gjitha ndashmit ne lidhje me kete paisje, por AK – Komisioni i vleresimit, qellimisht ne eliminon dhe ne Letren standarde te eliminimit nuk e jap asnej edhe nje faktet e vetem se pse ne nuk kemi arrit te plotesojme kete kerkese, pike te dosjes se tenderit, por vetem thote po citojm: " ju ne oferten tuaj keni paraqitur pasie tjeter ne kundërshtim, per kete arsye oferta e juaj eshte e pa pergjegjshem".. qe i bie se AK edhe pas sqarimeve te kerkuar dhe dorzimit te sqarimeve nga jone eshte dashur te theksoj dhe argumentoj se per cilat arsye apo/ose fakte ne si OE nuk kemi plotesuar, kur tashme jane ne e-prokurim dhe kemi dorezuar gjithë deshmit dhe provat per kete pajisje AUTOMIKESER PER PRODHIM TE BETONIT, mirepo AK ne letren standarde nuk jap asnjë fakt apo deshmi pse ne nuk e plotesojm kete kerkese?..... Shpresojm dhe lusim AK te na jap pergjigjie konkret me kete KpR duke u thirre ne PROVA dhe FAKET dhe dispozite ligjore dhe jo vetem ne emocione dhe te thena te pa verteta dhe pa jap argument konkret!..... NE edhe neje ehre po theksoje se kemi dorezuar te gjitha faktet dhe provat, Listen maikenerise/pasijeve, marrëveshjen mbi qiran, Librezat e qarkullimit, sigurimin nga Kompanit e sigurimit me regjistrim valid, ashtu si qeshte kerkuar ne DT dhe NJK.

Prove: Dokumente me rastin e Tenderit per kete AP, si dhe deshmit dhe faktet ne sqarimet e letres standarde te sqarimit te te tenderit dt. 14.05.2025

AK me rastin e vleresimit, elzamnimit dhe krahasimit te tendereve ne letren standade te elemnimit ka pershkrur dhe ka dhene nje pershkrimi te elemnimit, pa asnje fakte apo prove te VETMNE, vrehet lehte se kete e ka bare ZPP dhe jo komisioni i vleresimit duke mos dhene asnje prove me fakte dhe argumente por vetum duke pershkruar dhe duke u thirrur ne ndonje dispozite ligjore qe I mbeshket keto pershkrime qe nuk kane fakte dhe argumente konkret. Ne ja rikujtojm AK – ZPP dhe Komisionit te vleresimit se Vleresimi i tenderve duhet te behet ne pajtim te plote me nenin 7, 59 dhe 60 te LPP-së dhe jo te jep pershkrim dhe te thirret ne supozime, dhe HAMENDSIME dhe te jep kahje krjet tjeter duke mos marr per baze kriteret e perzgjedhjes por te thirret ne disa gabime tersisht minore dhe qe nuk kana asnje ndikimin ne qellimin e prokurimit dhe ekzekutimin e ketij AP sepse NE - OE kemi arrit te plotesojm te gjithë ne plotni dhe ne pajtim me nenin 59 dhe 60 te LPP-se ne jemi GOE te pergjegjshem.

Mirepo AK me vetedije dhe qellim te caktuar na eliminon padrjetesisht dhe duke na diskriminuar vetem e vetem per te mos na rekomanduar per kontrate, ne shkleje te nenit 62 te LPP-se, e elemnion ne teresi kete AP

INFORMIM per AK – ZPP – Komisionin e Vleresimit - (ESH dhe PSH)

AK me daten 11.03.2025 ka publikuat NJK (njoftimin per kontrate) ne e-prokurim

AK me date 14.04.2025 ka publikuar procerverbalin e hapjes , ku kemi tenderur edhe ne si GOE.

AK me date 07.07.2025 ka Publikuar – B58 Njoftimin mbi vendimin e AK duke na eliminuar me letres atndarde te eliminimit per “automikser per prodhimin e betoni” sikurse ne sqarimi me lart ne kete ankese?!.... DUKE a anuluar ne tersi AP me arsyetim se kinese asnjë OE nuk eshte i pergjegjshem?....

NE si OE kemi parashtruar KpR me date:13.07.2025

AK me date 18.07.2025 APROVON Kekresn per rishqyrtim dhe kethen ne rivlerësim AP.

Pastaj AK me date: 30.09.2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e AK duke na eliminuar me letres atndarde te eliminimit per “automikser per prodhimin e betoni” sikurse ne sqarimi me lart ne kete ankese?!.... Perseri me arsyetimin e njëjte dhe duke rekomanduar nje OE me te shtrejt se oferta jone

NE si OE kemi parashtruar perseri KpR me date: 06.10.2025

AK me date 08.10.2025 APROVON Kekresn per rishqyrtim dhe kethen ne rivlerësim AP.

AK me date 22.10.2025 ka Publikuar – B58 Njoftimin mbi vendimin e AK dhe nuk ka publikuar Letren standarde per Eleminim apo/ose si GOE i pasukseshem duke shkelur nenin 42 te Rregullores nr. 001/2022 per PP, duke rekomanduar OE EURO Comerc shpk

Prove: B058 njoftimi mbi vendimin e AK te dt. 22.10.2025

Ne si GOE tenderues ne kete AP, duke arrit te plotesojme te gjitha kriteret e perzgjedhjes te percaktuar ne dosje tenderit dhe njoftimit per kontrate si dhe duke plotesuar kriterin e dhenjes tenderi ekonomikisht me i favorshem, kemi marr qasjen pas vendimit B58 te dates 07.07.2025 dhe vazhimisht kemi parashtruar KpR sepse ky AP eshte anuluar fillimisht ne shklje te dispozitave ligjore te LPP dhe ne kemi parashtruar KpR dhe AK e ka aprovuar, po ashtu pas Rivleresimit AK ka rekomnadar nje GOE me cmim me te lart se sa ne dhe te papergjegjshem me date 29.09.2025, ku ne perseri kemi parashtruar perseri KpR e cila eshte aprovuar persri nga AK dhe eshte rivleresuar perseri dhe AK me date 22.10.2025 rekomandon me dheneie te kontrates nje OE te pergjegjshem me B58 , dhe ne perseri nuk pajtohemi me kete vendim dhe do te parshtrojm KpR perseri me date: 27.10.2025 brenda afateve ligjore te LPP!.....

Duke marr per baze se AK – ZPP me rastin e nxjerr se B58 njoftimit mbi vendimin e dates 22.10.2025 nuk na ka njoftuar permes letres standarde se jemi GO te pasukseshem apo/ose te eliminuar ne po perserisim pretendimin tone se jemi GOE te pergjjeshem dhe plotesojm/posedojme paisjen” “automikser per prodhimin e betoni”ashtu sic eshte kërkuar ne Dt dhe NJK si dhe kemi argumentuar permes sqarimeve te kërkuar nga AK ne vlerësimin fillestar..... Me fjalet jera ne besojm se AK do te reflektoj dhe te veproj ne pajtim te plote me dispozitat ligjore qe e rregullojn kete ceshtje duke kërkuar AK te kthej ne rivlerësim dhe te na rekomandoj per dhenie te kontrates pasi qe ne kemi tenderuar me çmimin me te lire dhe te pergjegjshem, andaj AK – ZPP me rastin e eleminit tone dhe anulimi e AP eshte ne shklje te nenit 7, 59, 60 dhe 62 te LPP-se dhe parimit kryesor te prokurimit “olera per para”. Pretendimi nr. 1

OE: Euro Commerc O.P. – Viti, - eshte i papergjegjshem per faktin se Automikeseri i prezantuar nga ky OE per kete AP nuk eshte ne pajtim me DT dhe NJK, per faktin se ka prezantuar nje

automikser per transportin e betonit dhe jo nje Automikseser per prodhimin e betonit, andaj ky fakte e ben te papergjegjeshem,

Prove: libreza e qarkullimit deshmon se eshte aototransportues betoni dhe jo atomikes per prodhimin e betonit, ashtu sic kemi dorezuar ne dhe qe deshmon se ne kemi dorezuar atomikes per prodhim betoni ashtu sic eshte kerkuar ne DT dhe NJK, andaj ky fakte e bene te papergjegjshem kete OE per kete aktivitet te prokurimit.

Prandaj, AK me keto procese te vleresimit dhe rivleresimit disa here ka shkelur dispozitat e LPP-se, duke na dikriminuar dhe duke e zvarritur pa arsye kete AP.

Pretendeimet ankimore kunder OE: Marisa Shpk Gjakove - NUI: xxxxx596

Pretendimi nr. 1

OE: Marisa Shpk Gjakove - eshte i papergjegjshem per faktin se Automikseseri i prezantuar nga ky OE per kete AP nuk eshte ne pajtim me DT dhe NJK, per faktin se ka prezantuar nje automikser per transportin e betonit dhe jo nje Automikseser per prodhimin e betonie, andaj ky fakte e ben te papergjegjeshem, Prove libreza e qarkullimit deshmon se eshte aototransportues betoni dhe jo atomikes per prodhimin e betonit ashtu sic kemi dorezuar ne dhe qe deshmon se n ekemi dorezuar atomikes per prodhim betoni ashtu sic eshte kerkuar ne DT dhe NJK, andaj ky fakte e ben te papergjegjshem kete OE per kete aktivitet te prokurimit. Pretendeimet ankimore kunder GOE: DACH Group spk; NIVA Construction Shpk; Harst Group Shpk Prishtine - NUI: xxxxx617

Pretendimi nr. 1

GOE: DACH Group spk; NIVA Construction Shpk; Harst Group Shpk Prishtine - eshte i papergjegjshem per faktin se Automikseseri i prezantuar nga ky OE per kete AP nuk eshte ne pajtim me DT dhe NJK, per faktin se ka prezantuar nje automikser per transportin e betonit dhe jo nje Automikseser per prodhimin e betonie, andaj ky fakte e ben te papergjegjeshem, Prove libreza e qarkullimit deshmon se eshte aototransportues betoni dhe jo atomikes per prodhimin e betonit ashtu sic kemi dorezuar ne dhe qe deshmon se n ekemi dorezuar atomikes per prodhim betoni ashtu sic eshte kerkuar ne DT dhe NJK, andaj ky fakte e ben te papergjegjshem kete OE per kete aktivitet te prokurimit.

Pretendeimet ankimore kunder GOE dhe OE te cilet kane tenderuar mbi oferten financiar te ofertes tone jane te pa pergjegjshem ashtu sic ka percaktuar AK ne letrat standarde dhe jane palë pa interes sipas nenit 4.1.26 te LPP-se, ne kete AP. Disa Tenderues edhe nuk kan vazhduar vlefshmerin e tenderit dhe sigurimin e tenderit. ".

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

"Ju si OE-ik nuk keni oferte te papergjegjshem per arsye se GOE-ik me oferten e tij nuk ka dorezuar sipas kerkese se DT-se dhe njoftimit per kontrate: Pika 4. i) 1 (Një) automikser per prodhimin e betonit (me regjistrim valid)Deshmia e kerkuar dokumentare: Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për te ekzekutuar kontraten në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmoohen me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe me kontratë mbi qeramarrjen per kete projekt..., ju ne oferten tuaj keni paraqitur pasie tjeter ne kundërshtim, per kete arsye oferta e juaj eshte e pa pergjegjshem".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar apo tenderuesve të tjerë është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.11.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.